



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Prilidheni / Prodato Received / Delivered	05-04-2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtoja e Pitlog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSTEK	3324/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 374/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësi+ kanë shqyrtuar ankesën A. Nr. 374/2023 të datës 20.02.2023, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi rruga „Tahir Sinani” nga Komuna e Lipjanit kundër organit të punësimit Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 05.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 374/2023 të datës 20.02.2023 e parashtruar nga ankuesja.
- II. Lënda e ankueses dërgohet në Komisionin e Ankesave për Shërbyes Publik në Komunën e Lipjanit.

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 20.02.2023, me numër protokollit 1884, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore, që Këshilli të obligojë Komunën e Lipjanit që ankuesen të sistemoj në kategorinë e shërbyesve publik dhe ti ofertojë kontratën e punës me pagë bazë në bazë të koeficientit të caktuar për vendim e punës, Zyrtare e Lartë e Personelit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, si dhe ti kompozohet diferenca në pagë si për shërbyes publik, nga data 01.11.2017, për pa realizuar në mënyre retroaktive.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 374/2023 të datës 20.02.2023 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër 1-112-460 i datës 10.01.2017, i Kryetarit të Komunës së Lipjanit; Vendimi me numër 1-112-20397 i datës 21.04.2017, i Kryetarit të Komunës së Lipjanit; Akt Emërimi i datës 01.11.2017; Lista e pagave për periudhën 01.01.2017, deri me datën 31.01.2017; Lista e pagave për periudhën 01.01.2017, deri me datën 31.01.2017; Lista e pagave për periudhën 01.02.2017, deri me datën 28.02.2017; Lista e pagave për periudhën 01.03.2017, deri me datën 31.03.2017; Lista e pagave për periudhën 01.04.2017, deri me datën 31.04.2017; Lista e pagave për periudhën 01.05.2017, deri me datën 31.05.2017; Lista e pagave për periudhën 01.06.2017, deri me datën 31.06.2017; Lista e pagave për periudhën 01.07.2017, deri me datën 31.07.2017; Lista e pagave për periudhën 01.08.2017, deri me datën 31.08.2017; Lista e pagave për periudhën 01.09.2017, deri me datën 31.09.2017; Lista e pagave për periudhën 01.10.2017, deri me datën 31.10.2017; Lista e pagave për periudhën 01.11.2017, deri me datën 31.11.2017; Konkursi i datës 22.06.2017;

Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me pretendimet ankimore që Këshilli të obligojë Komunën e Lipjanit që ankuesen të sistemoj në kategorinë e shërbyeseve publik dhe ti ofertojë kontratën e punës me pagë bazë në bazë të koeficientit të caktuar për Vendim e punës Zyrtare e Lartë e Personelit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, si dhe ti kompozohet diferenca në pagë si për shërbyes publik nga data 01.11.2017. Kolegji ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses

Bazuar në shkresat e lëndës del së ankuesja në bazë të Akt Emërimit të datës 06.11.2017, mbanë pozitën e punës "Zyrtare e Lartë e Personelit", në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Lipjanit, kolegji konstaton se ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit civil, prandaj Kolegji konstaton se në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, Këshilli nuk është kompetent për ta shqyrtuar ankesën e ankueses pasi që ankuesja nuk ka statusin e nëpunësit civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që i ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar se lidhur me pretendimet ankimore që Këshilli të obligojë Komunën e Lipjanit që ankuesen të sistemoj në kategorinë e shërbyeseve publike dhe ti ofertojë kontratën e punës me pagë bazë në bazë të koeficientit të caktuar për Vendim e punës, Zyrtare e Lartë e Personelit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, si dhe ti kompozohet diferenca në pagë si për shërbyes publik, nga data 01.11.2017, e pa realizuar në mënyre retroaktive kolegji konstaton se pozita e ankueses, nuk është pozitive e shërbyesit civil ashtu siç përcaktohet në bazë të dispozitave të nenit 2, paragrafi 4, të Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; **4. Nëpunës i Shërbimit Publik-është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.**

Bazuar nën 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për praninë në Shërbimin civil, siç është përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe paragrafi 3 si dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet së: **Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente**, prandaj Komisioni për Shërbyes Publik në Komunën e Lipjanit duhet ta trajtojë lëndën e ankueses sepse ai Komision është kompetent për kategorinë e shërbyesve publike duke u bazuar edhe në nenin 74 të Ligjit nr.06/L-114 për Shërbyesit Publik.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.374/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

Ankueses

Kryetarit të Komunës së Lipjanit;

Drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Lipjanit;

Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit;

Komisionit të Ankesave për Shërbyes Publik në K-Lipjan

Arkivit të KPMSHCK-së